

## KOMUNA E VUSHTRRIË

### NJOFTIMI PËR KONKURSIN E PROJEKTIMIT

Sipas Nenit 75 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit:

Nr. i Prokurimit	VU644-23-3048-4-2-3
Nr. i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip



Serbisht



Anglisht



#### NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

##### I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar: <b>KOMUNA E VUSHTRRIË</b>		
Adresa Postare: <b>SHESHI " HASAN PRISHTINA" NR 173</b>		
Qyteti: <b>VUSHTRRI</b>	Kodi postar: <b>42000</b>	Vendi: <b>Kosovë</b>
Personi kontaktues: <b>Personi Përgjegjës: Albanëz Tahiraj</b> <b>Personi Kontaktues: Xhafer Islami</b>		Telefoni: <b>038/200-42403</b>
Email: <b>prokurimi.vushtrri@rks-gov.net</b>		Faksi:
Adresa e Internetit (nëse aplikohet): <b><a href="https://kk.rks-gov.net/vushtrri/">https://kk.rks-gov.net/vushtrri/</a></b>		

Konkursi përfshinë prokurimin e përbashkët

Po



Jo



Konkursi udhëhiqet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Po



Jo



*Nëse po*, specifiko identitetin e të gjitha Autoriteteve Kontraktuese ose referoju një Aneksi.

#### NENI II: LËNDA E KONKURSIT TË PROJEKTIMIT/PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

##### II.1) PËRSHKRIMI

**II.1.1) Titulli i dhënë për konkursin e projektimit/projektin nga autoriteti kontraktues:  
Konkurs projektimi për hartimin e projektit rikonstruimi I bulevardit Adem Jashari dhe lidhja me parkun e qytetit , Vushtrri - Ritender**

### **II.1.2) Përshkrimi i shkurtër për konkursin e projektimit/projektin**

Qëllimi kryesor i këtij projekti do të jete rikonstruimi i sheshit me të gjitha elementet e infrastrukturës dhe ndërlidhja me parkun e qytetit ,me qellim te përmirësimit të cilësisë së hapësirës publike qe ndikon ne jetën e banorëve për te krijuar ambient miqësor dhe rekreativ.

### **II.1.3) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP)**

74232200-6

## **NENI III: INFORMACIONE LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE**

### **III.1) KUSHTET PËR PJESMARRJE**

#### **III.1.1)**

#### **Kërkesat e përshtatshmërisë:**

**Kërkesa 1 . Operatori ekonomik duhet të përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092 , Neni 65**

#### *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

**Dëshmia 1. Lidhur me nenin 65, paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, të LPP-së me të cilën dëshmohet se tenderuesi i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë për të konkuruar. Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik , duke përdorur formën në Aneksin 2 të Dosjes Tenderit.**

**Dëshmitë lidhur me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblej me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo me pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës.**

**Dëshmia 2. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 4.1, 4.2 dhe 4.4 të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Komerciale) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik. Ekstrakti Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik të cilit synohet dhënia e kontratës (Original apo kopje e Noteruar )**

**Dëshmia 3. Në lidhje me Nenin 65, paragrafët 3.1, 3.2, 3.3, 3.4, 3.5, 3.6, të LPP-së, një ekstrakt nga regjistri gjyqësor (Gjykata Themelore e vendit të themeluesit të OP. Ek.) apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent i lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ të vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, që vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë që të merrë pjesë në një aktivitet të prokurimit dhe se ndaj tij nuk ekziston ndonjë rrethanë e përcaktuar me Nenin 65. Ekstrakti Dokumenti**

	<p>nuk duhet të jetë më i vjetër se 6 muaj nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Operatori Ekonomik. të cilit synohet dhënia e kontratës, të dorëzohet në Origjinal ose Kopje e Noteruar.</p> <p>Dëshmia 4. Në lidhje me Nenin 65, paragrafi 4.8 i LPP-së, për kontributin e taksave një dëshmi e lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik .</p> <p>Dëshmia Dokumenti nuk duhet të jetë më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë, duhet të dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës (Kopje) Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla nga Operatori ekonomik i rekomanduar për shpërblim me kontratë, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdoj me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se.</p>
<p><b>III.1.2)</b>  <b>Përshtatshmëria profesionale:</b>  <b>Kërkesa 1.</b> Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit  <b>Kërkesa 2.</b> Operatori Ekonomik duhet të jetë i regjistruar si deklarues i TVSH-së.</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>Dëshmia 1.</b> Kopja e certifikatës të regjistrimit të biznesit së bashku me veprimtaritë e regjistrimit  <b>Dëshmia 2.</b> Çertifikata e TVSH-së valide të dorëzohet në kopje</p>
<p><b>III.1.3)</b>  <b>Kapaciteti ekonomik dhe financiar:</b>  <b>Nuk Kërkohe</b></p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>N A</b></p>
<p><b>III.1.4)</b>  <b>Kapaciteti teknik dhe professional:</b>  <b>Kërkesa 1.</b> Operatori Ekonomik duhet të ketë kontrata të shërbimeve të ngjashme të realizuara - përfunduara, në periudhën e shkuar tre vjeçare nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë dhe atë jo më pak se 90,000.00Euro.</p> <p><b>Kërkesa 2.</b> Operatori ekonomike duhet te angazhoj staf profesional te cilët duhet te kenë kualifikimet shkollore te mëposhtme</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>  <b>Dëshmia 1.</b> Listën me të cilën specifikohen të gjitha kontrata e shërbimeve të ngjashme të realizuara përfunduara, ku duhet saktësuar Titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit të cilës duhet bashkangjitur certifikata ose referencë për kryerje dhe ose përfundim të kënaqshëm të projekteve kontratave të shërbimeve.  (i) Kur shërbimet janë kryer për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të kryerjes përfundimit të shërbimeve shërben kopja e certifikatës (certifikatave) ose referencë a, të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë në shkruara nga autoriteti i tillë;  (ii) Kur shërbimet janë kryer për një blerës privat, për dëshmi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i shërbimit të tillë.  <b>Dëshmia 2 .</b> Lista e stafit profesional ,ku listës duhet ti bashkëngjiten këto dëshmi -  <b>Diploma; - CV; - Kontrata te</b></p>

a) Një (1) Menaxher te projektit - Inxhinier i diplomuar i Arkitekturë ose Master i Arkitekturë (preferohet drejtimi Planifikim Dizajn urban ) me minimum 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë menaxhuar se paku dy projekte te natyrës se ngjashme me aktivitetin; b) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Arkitekturë ose Master i Arkitekturë (preferohet drejtimi planifikim mjedisor ose urbanistikë) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin; c) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Arkitekturë ose Master i Arkitekturë (preferohet drejtimi Arkitekt Peizazhi) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin d) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Komunikacionit dhe transportit ose Master i Komunikacionit dhe transportit (drejtimi Komunikacion dhe transport) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin e)

e) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i Ndërtimtarisë (drejtimi konstruktiv ) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin f) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë ose Master i Ndërtimtarisë (drejtimi Hidroteknikës ) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin g) Një (1) Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës ose Master i Elektroteknikës is (drejtimi energjetik ) me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit në projekte të natyrës së ngjashme me aktivitetin

punës me punëdhënësin ose marrëveshje mbi angazhimin për këtë projekt, si dhe per kërkesën a) duhet te dorëzohet si dëshmi referenca .

**III.1.5) A është rezervuar pjesëmarrja për profesionin e caktuar:**

Po  Jo

*Nëse po, tregoni profesionin*

**III.1.6) Vendi ku do të realizohet projekti:**

**Vushtrri**

## NENI IV: PROCEDURA

### IV.1) LLOJI I KONKURSIT

**IV.1.1) Lloji i procedurës**

E hapur

E kufizuar

**IV.1.2) Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim (procedura e kufizuar)**

Në bazë të aplikacioneve të pranuar, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar projektin. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për procedurën e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të merren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:

#### IV.2) KRITERET QË DO TË APLIKOHEN NË VLERSIMIN E PROJEKTEVE

Nën-kriteret	Pesha në %
Vlerësimi Teknik	70%
Vlerësimi Financiar	30%

#### IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

##### IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njejtë

Po  Jo

*Nëse po,*

Njoftimi paraprak: i

Publikimet e tjera (*nëse aplikohen*)

i

i

##### IV.3.2) Kushtet për marrjen e dosjes së konkursit / dokumentet e para-kualifikimit

Afati i fundit për pranimin e kërkesave për *dosje të konkursit / dokumentet e para-kualifikimit*

Data koha

##### Dokumentet me pagesë:

Po  Jo

*Nëse po,* çmimi EUR

Kushtet dhe mënyra e pagesës:

##### IV.3.3) Afati kohor për pranimin e projekteve / aplikacioneve:

**Data 24.04.2023 koha 14:00:00 vendi Komuna e Vushtrris kati III-të, zyra nr.45**

IV.3.4) Projektet apo kërkesat për pjesëmarrje mund të merren në gjuhën Shqipe, S rbe dhe Angleze.

#### IV.4) SHPËRBLIMET

##### IV.4.1) Çmimi/çmimet do të open:

Po  Jo

*Nëse po,* numri dhe vlera e çmimeve të cilat do të shpërblehen:

##### IV.4.2) Detajet e pagesës/vlerat e çmimeve që do të jepen:

##### IV.4.3) Kontratat përcjellëse

Cilado kontratë e shërbimeve e cila shoqëron konkursin do t'i jepet fituesit apo njërit prej fituesve të konkursit:

Po  Jo

##### IV.4.4) Vendimi i jurisë është detyrues për autoritetin kontraktues:

Po  Jo

## **NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE**

### **V.1) ANKESAT**

**Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 në adresën e specifikuar në Nenin I të këtij Njoftimi.**

### **V.2) INFORMACIONET SHITESË**

*Shto informacione tjera:*

**1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojnë tenderët vetëm përmes platëformës elektronike. Tendertet e dorëzuar në kopje fizike, do të refuzohen për nga aspekti administrativ. 2. Operatori ekonomik me rastin e aplikimit qoftë individualisht ose si grup i operatorëve ekonomik, duhen të jenë të regjistruar në Platformën elektronike të prokurimit publik.**